




Republika e Kosovës - Republika Kosova	
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica	
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administratëve	
Lprava za Opštë, Administrativne Poslove	
01	Nr./Br. 413101-3623
Data	28.01.2019
Gjakovë - Djakovica - Gjakova	



KOMUNA E GJAKOVËS

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I lidhur me dt. 28.01.2019, ndërmjet:

1. Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (Voice of Roma, Ashkali and Egyptians) si Organizate Joqeveritare me numër të regjistrimit 5113364-1 pranë Ministrisë se Administratës Publike, me adresë në rrugën Milosa Obilica në Graçanicë, 10500 Prishtinë, të cilën e përfaqëson Drejtori Ekzekutiv Isak Skenderi, në tekstin vijues VORAE;
2. Komunës së Gjakovës të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës Ardian Gjini, në tekstin vijues Komuna;

1. Qëllimi i Marrëveshjes

Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe banimit së grupeve te marginalizuara me fokus tek romët, ashkalitë dhe egjiptianët dhe përmirësimi i situatës së tyre sociale në Komunën e Gjakovës.

Kjo ndërhyrje gjen bazën në Strategjinë Kombëtare për Përfshirjen e Romëve dhe Ashkalive 2017-2021, Plani Lokal i Veprimit të Komunës së Gjakovës dhe mbështetet me Projektin për Përfshirjen Sociale RAESI II të zbatuar nga Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptasve në bashkëpunim me Fondacionin Zviceran HEKS dhe Fondacionin Zviceran Terre des hommes dhe financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Prishtinë.

2. Kushtet e përgjithshme

OJQ VoRAE do të aplikojë qasjen e përmirësimit të shtëpisë të drejtuar nga banorët e projektuar dhe testuar në konsultime të ngushta me partnerët tanë zviceranë nga HEKS dhe SKAT dhe përshtatur për rrëthanat dhe nevojat e Kosovës.

Parimi themelor është të sigurohet se familjet janë të lidhura me sistemet publike të ujit dhe kanalizimeve dhe që ata të kenë qasje në hapësirë adekuate të jetesës dhe banjo funksionale me ujë të ngrohtë.

Projekti parashev këto modele për ndërtimin:

- MODEL 5: Riparime në shtëpitë ekzistuese prej 1.000 €.
- MODEL 4: Ndërtimin e banjos funksionale prej 1.500 €.
- MODEL 3: Riparime te shtëpisë ekzistuese ose ndërtimi i aneks hapësire banimit me banjo funksionale deri ne 27 m² ne kategorinë prej 3.500 €.
- MODEL 2: Riparime te shtëpisë ekzistuese ose ndërtimi i aneks hapësire banimit me banjo funksionale deri ne 41 m² ne kategorinë prej 4.800 €.
- MODEL 1: Shtëpi me banjo funksionale prej 60 m² në kategorinë prej 6.800 €.

Ndërsa OJQ-ja VORAE do të sigurojë të gjitha materialet e ndërtimit që kërkohen për të përfunduar ndërhyrjen bazuar në modelet e lartpërmendura, familja është e obliguar të kryejë të gjitha punimet e ndërtimit, përveç instalimit të ujit dhe energjisë elektrike, të cilat do të sigurohen nga Organizata.

Për të siguruar që cilësia minimale e ndërhyrjes zbatohet, OJQ-ja do të angazhojë masonët profesionistë për të monitoruar, udhëzuar dhe këshilluar familjet gjatë fazës së ndërtimit.

Buxheti i paraparë për përmirësimin i kushteve të jetesës dhe banimit të grupeve te marginalizuara me fokus tek romët, ashkalitë dhe egjiptianët dhe përmirësimi i situatës së tyre sociale në Komunën e Gjakovës ne baze te kësaj marrëveshje është 52,000.00 €, nga i cili:

Komuna e Gjakovës do te ndaje 25.000.00 €, dhe

VORAE do te ndaje 27.000.00 €.

Mjetet financiare të përmendura ma larte, Komuna e Gjakovës do ti transferoj në xhirrollogarinë e organizatës VORAE në me nr. 1167002199000133 në ProCredit Bankë. Bartja e mjeteve prej nga Komuna e Gjakovës në llogarinë e organizatës VORAE do të bëhet si ne vijim:

- Kësti i parë ne shumen prej 33% nga totali i kontraktuar nga Komuna tek organizata VORAE bëhet pas nënshkrimit të marrëveshjes.
- Kësti i dyte ne shumen prej 33% nga totali i kontraktuar nga Komuna tek organizata VORAE behet pasi qe organizata VORAE ti dorëzojë të gjitha faturat e këstít të pare tek Komuna e Gjakovës duke arsyetuar kështu shpenzimet e këstít të parë.
- Kësti i tretë në shumën prej 34 % nga totali i kontraktuar do të bëhet pasi që VORAE ti dorëzoje të gjitha faturat e këstít të dytë tek Komuna e Gjakovës duke arsyetuar kështu shpenzimet e këstít të dytë dhe format e inspektimit final për te arsyetuar punën e ndërtimit në terren.

3. Veprimet konkrete te Komunës së Gjakovës

- Pas nënshkrimit të marrëveshjes Kryetari i Komunës së Gjakovës do të përcaktojë Departamentin Përgjegjës me të cilin VORAE do të ketë bashkëpunim të ngushtë.
- Komuna e Gjakovës duhet të publikojë shpalljen për aplikim të familjeve që kanë nevojë për ndërhyrjen e projektit.
- Do të autorizohet komisioni deri në 3 persona nga Kryetari i Komunës se Gjakovës, të cilët do të jenë të pranishëm në procesin e vizitave në familje dhe selektimin e tyre.

4. Veprimet konkrete te VORAE

- VORAE si OJQ implementuese do t'ia komunikojë Komunës vendimet dhe aktivitetet e kryera në Komunën e Gjakovës, dhe në rast nevoje do të kërkojë nga organet kommunale të ndihmojnë në procesin e vendim-marrjes.
- VORAE do të koordinoj secilin aktivitet të implementuar në fushën përkatëse të projektit me departamentet përgjegjës të autorizuar nga Kryetari i Komunës.
- VORAE do të bëjë përzgjedhjen e kompanive për furnizim me material ndërtimorë me komision të përbashkët me pjesëtaret e Komunës në të cilat implementohet projekti i banimit.
- VORAE gjatë tërë procesit të ndërtimit do të monitorojë punimet tek familjet përfituese dhe në përfundim të punimeve ndërtimore është e obliguar të dorëzojë tek komuna dosjen me dokumentet të cilat arsyetojnë tërë procesin implementues si dhe kopjet e faturave për shpenzimet në vlerë prej 52.000.00 €.

5. Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit dhe është valide deri ne përfundim të punimeve ne ndërtimin e shtëpive, por jo ma gjate se deri ne 31 Dhjetor 2019.

6. Kushtet e Veçanta

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është e plotfuqishme që nga Janar, 2019 deri ne Dhjetor, 2019.

Kjo marrëveshje është bërë në dy kopje origjinale për secilën palë nga një formë.

Në rast se kjo marrëveshje nuk respektohet atëherë palët janë të obliguara të njoftojnë palën tjetër 30 ditë më herët për shkëputjen e marrëveshjes.

PALËT

